




NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE
Me dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023





NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.

Adresa: Rr. Tirana p.n. Gjakovë

NUI: 811326471

DEKLARATË E PAJTUESHMËRISË

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2023 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në Pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.


Blerim Halilaj
Kryeshef Ekzekutiv




Albina Domi
Drejtor Financiar

PËRMBAJTJA:

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR.....	4
RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE.....	7
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
1. Informata të përgjithshme.....	12
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare	12
3. Politika të rendësishme kontabël	13
4. Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar	19
5. Prona, Pajisjet dhe Makineritë	21
6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.....	22
7. Stoqet.....	22
8. Pasuritë tjera afatshkurta	22
9. Paraja dhe Ekuivalentët e saj	22
10. Kapitali Aksionar	23
11. Të hyrat e shtyra	23
12. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera.....	23
13. Detyrimet tjera afatshkurta	23
14. Të hyrat	24
15. Kosto e mallit të shitur	24
16. Shpenzimet e personelit	24
17. Shpenzimet administrative.....	25
18. Shpenzimet e tatimit në fitim.....	26
19. Transaksionet me palët e lidhura	26
20. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut.....	27
21. Kontigjencat dhe zotimet.....	29
22. Ngjarjet pas datës së raportimit	29

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e Ngrohtorja e Qytetit SH.A.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ngrohtorja e Qytetit SH.A. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2023 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve tek baza për opinion me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion me rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 5, Prona, Impiantet dhe Pajisjet deri me 01 janar 2008 barten sipas kostos së vlerësuar minus çdo amortizim dhe humbje e akumuluar nga zhvlerësimi. Pas datës 01 janar 2008 Prona, Impiantet dhe Pajisjet janë vlerësuar sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet, rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt mjaftueshëm që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Rivlerësimi i fundit i Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve të Kompanisë është kryer me 31 dhjetor 2006 nga një kompani vlerësuese e licencuar.

Siç është paraqitur në shënimin 5 të Pasqyrave Financiare Prona, Impiantet dhe Pajisjet mbartin vlerën neto me datën 31 dhjetor 2023: 15,131,901 Euro (31 dhjetor 2022: 15,993,140 Euro). Ne nuk ishim në gjendje përmes procedurave alternative të auditimit të vlerësojmë se vlera bartëse e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve është prezantuar në përputhje me kërkesat e SNK16 përpos vlerës së Kogjenerimit i cili është bërë pranimit Teknik në vitin 2021 dhe është bartur me vlerën e kostos/donacionit. Gjithashtu për shkak çështjeve të lartëcekura ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse rezerva e zhvlerësimit e paraqitur në pasqyrat financiare është e përshtatshme për të pasqyruar vlerën e totalit të Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve në krahasim me vlerën e rikuperueshme të saj.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuadojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
25 mars 2024



RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Ngrohtorja e Qytetit SH.A. si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raport i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përparitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor te kompanisë Ngrohtorja e Qytetit SH.A. për periudhën 01 janar 2023 - 31 dhjetor 2023, me datë 12 dhjetor 2023 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

Vlerësimet kontabël

Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

Përgjigja e auditorit

- o Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
 - o Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
 - o Rishikimi i saldove dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'i përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
 - Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
 - Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
25 mars 2024



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

Më 31 dhjetor	Shënimi	2023	2022
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe implantet	5	15,131,901	15,993,140
Gjithsej pasuritë afatgjata		15,131,901	15,993,140
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	263,142	198,488
Stoqet	7	249,458	294,436
Pasuritë e tjera afatshkurtra	8	79,225	194,695
Paraja dhe ekuivalentët e parashë	9	161,517	174,560
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		753,342	862,179
Gjithsej pasuritë		15,885,242	16,855,319
DETYRIMET DHE EKUITETI			
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	2,143,322	2,143,322
Fitimet e mbajtura		(1,797,036)	(1,566,553)
Gjithsej ekuiteti		346,287	576,769
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet e tjera afatgjata	11	14,894,779	15,717,935
Gjithsej detyrimet afatgjata		14,894,779	15,717,935
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	467,904	272,913
Të hyrat e shtyra afatshkurtra	11	137,915	225,870
Detyrimet e tjera afatshkurtra	13	38,358	61,832
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		644,177	560,615
Gjithsej detyrimet		15,538,955	16,278,550
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		15,885,242	16,855,319

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar nga menaxhmenti i Ngrohtorja e Qytetit SH.A. dhe janë nënshkruar më 03 mars 2024 në emër të:


Blerim Halilaj
 Kryeshef Ekzekutiv


Arbina Domi
 Drejtor Financiar


Miranda Zherka
 Kontabilist i Përfundimtar

Kontabilist i Përfundimtar e Certifikuar
 KKK Niveli KKK V ECVET 5205

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

		2023	2022
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor			
	<i>Shënimi</i>		
Të hyrat	14	1,872,519	1,963,184
KMSH	15	(854,370)	(808,516)
Total të hyrat		1,018,150	1,154,668
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet e pagave	16	(227,154)	(204,739)
Shpenzimet administrative	17	(69,293)	(79,844)
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	(952,185)	(890,555)
Fitimi / (humbja) operativ		(230,483)	(20,470)
Të ardhurat / (Shpenzimet) financiare		-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		(230,483)	(20,470)
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit	18	(230,483)	(20,470)

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat Euro

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2022	2,143,322	(1,546,084)	597,239
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(20,470)	(20,470)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,143,322	(1,566,553)	576,769
Gjendja më 1 janar 2023	2,143,322	(1,566,553)	576,769
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(230,483)	(230,483)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,143,322	(1,797,036)	346,287

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat Euro

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor		2023	2022
<i>Shënimi</i>			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		(230,483)	(20,470)
Fitimi / (humbja) i / e vitit			
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe Implantave	5	952,185	890,555
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		721,703	870,085
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	(64,654)	(25,624)
(Rritja) / zvogëlimi në stoke	7	44,978	(101,469)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	8	115,470	(42,521)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	194,991	114,697
Rritja / (zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	11	(911,111)	1,652,736
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet tjera	13	(23,474)	15,302
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		77,903	2,483,206
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe implantave	5	(90,946)	(2,723,846)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(90,946)	(2,723,846)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Ripagimi i kredive dhe huave		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		(13,043)	- 240,640
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	9	174,560	415,200
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	9	161,517	174,560

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

1. Informata të përgjithshme

Ngrohtorja e Qytetit Sh.A. është një shoqëri aksionare që u regjistrua në agjencinë e regjistrimit të bizneseve në Kosovë më 23/12/2005 me numrin e regjistrimit të biznesit 70325321 dhe numër unik identifikues 811326471. Zyra qendrore e kompanisë është e vendosur në Gjakovë, Rr, Tirana p.n.

Aktiviteti e kompanisë sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK):

Kodi	Përshkrimi	Tipi
3530	Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar	Primarë
3511	Prodhimi i energjisë elektrike	Sekondarë

Gjatë vitit 2023 Kompania kishte mesatarisht 37 të punësuar (2022: 34 punëtorë).

Pronar i Kompanisë është Komuna e Gjakovës me 100% të aksioneve.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar.

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro që është edhe valuta funksionale e kompanisë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-në kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të ardhurave janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë që supozon që kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe ti mbulojë detyrimet gjatë rrjedhës normale të biznesit.

3. Politika të rendësishme kontabël

a) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet.

Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronësimplanteve dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimitato trajtohen si zëra të veçantë (komponenta kryesore) të implanteve dhe pajisjeve.

Një zë i pronës dhe pajisjeve regjistrohet në rast se shitet ose kur nuk ka përfitime të ardhme ekonomike që pritet të lindin nga përdorimi i vazhdueshëm i pasurisë. Çdo fitim ose humbje që krijohet me rastin e shitjes së një zëri të pronësimplanteve dhe pajisjevepërcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të pasurisëdhe njihet në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet sipas vlerës bartëse të zërit nëse përfitimi i ardhshëm ekonomik i integruar mbrenda pjesës së pasurive është i mundshëm të rrjedhë në kompani dhe kosto e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve nga dita në ditë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas metodës lineare përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit të pasurive. Metodatat zhvlerësimitjetët e përdorimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë domethënëse) rivlerësohen në datën e raportimit.

Jetët e vlerësuarat të përdorimit për periudhat e tanishme dhe krahasuese ishin siç vijon;

Përshkrimi	Norma vjetore
Mjete transporti	20%
Makineri e vegla pune	20%
Pajisje informatike & Software	20%
Mobilje e orendi	20%

b) Pasuritë financiare

Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen dhe regjistrohen në bazë të datës së tregtisë. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të pasurive financiare që kërkojnë shpërndarjen e pasurive mbrenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

Të gjitha pasuritë e njohura financiare maten më pas në tërësi ose me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtënë varësi të klasifikimit të pasurive financiare.

Kasifikimi i pasurive financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me koston e amortizuar:

- Pasuria financiare mbahet mbrenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuarat të fluksit të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ):

- Pasuria financiare mbahet brenda një modeli biznesobjektiv i të cilit arrihet nga të dyja mbledhjet e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të përcaktuara flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Të gjitha pasuritë e tjera financiare maten më pas me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH). Përkundër kësaj më sipërkompania mund të bëjë zgjedhjet / përcaktimin e pakthyeshmë të mëposhtëm në njohjen fillestare të një pasurie financiare:

- Kompania mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshime të mëvonshme në vlerën e drejtë të një investimi në kapital në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në përmbushjen e kriterit të caktuar (shiko më poshtë); dhe
- Kompania mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një investim borxhi që plotëson koston e amortizuar ose kriteret e VDPATGJ të matura në VDPFH nëse duke bërë kështu eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje të kontabilitetit (shiko më poshtë):

(i) Kostoja e amortizuar dhe metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është një metodë e logaritmes së koston të amortizuar të një instrumenti borxhi dhe shpërndarjes së të ardhurave nga interesi për periudhën përkatëse.

Për pasuritë financiare përveç pasurive financiare të cilat kanë rënë në vlerëtë blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së kompanisë (d.m.th. pasuritë të cilat janë të dëmtuara nga kredia në njohjen fillestare) norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit vlerat e arketimeve të vlerësuar në të ardhmen (përfshirë të gjitha tarifat e paguara ose pranuar që formojnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit kostove të transaksionit dhe primeve ose zbritjeve të tjera) duke përjashtuar humbjet e pritura të kredisëpërgjatë jetës së pritshme të instrumentit të borxhitosekur është e përshtatshme një periudhë më të shkurtër në vlerën kontabël bruto të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare. Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerëtë blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së kompanisë një normë efektive interesi e rregulluar nga kredia llogaritet duke zbritur flukset e vlerësuar të parasë së ardhshme përfshirë humbjet e pritura të kredisë në koston e amortizuar të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare.

Kostoja e amortizuar e një pasurie financiare është shuma në të cilën pasuria financiare matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryerplus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj shume fillestare dhe shumës së maturimit të rregulluar për çdo humbje kompensimi. Vlera kontabël neto e një pasurie financiare është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare para se të rregullohet për çdo rënie në vlerë.

Të ardhurat nga interesi njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv për instrumentet e borxhit të matur më pas me koston e amortizuar dhe në VDPATGJ. Për pasuritë financiare përveç pasurive financiare të rena në vlerëtë blera ose të gjeneruara mbrenda portfolios së kompanisë të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të një pasurie financiare përveç pasurive financiare që më pas kanë rënë në vlerë (shiko më poshtë). Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerëtë ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet e këmbimit valuator

Vlera kontabël e pasurive financiare të shprehura në një valutë të huajpërcaktohet në atë valutë të huaj dhe të konvertuara në kursin e këmbimit në fund të çdo periudhe raportuese. Specifikisht:

- Sasia kontabël e pasurisë financiare që janë të shprehura në fund të çdo periudhe raportimi. Në mënyrë të veçantë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve;
- Për instrumentet e borxhit të matur në VDPATGJ që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit në koston e amortizuar të instrumentit të borxhit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve. Diferencat e tjera të këmbimit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve;
- Për pasuritë financiare të matura në VDPFH që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin e "fitimeve dhe humbjeve të tjera"; dhe
- Për instrumentet e kapitalit të matur në VDPATGJ diferencat e këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve.

Çregjistrimi i pasurive financiare

Kompania çregjistron një pasuri financiare vetëm kur skadojnë të drejtat kontraktuale të fluksit të parave nga pasuria ose kur transferon pasurinë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në një entitet tjetër. Nëse Kompania nuk transferon dhe nuk mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë pasurinë e transferuar kompania njeh interesin e saj të mbajtur një pasuri dhe një detyrim shoqërues për shumat që mund të duhet të paguajë.

Për çregjistrimin e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar diferenca midis vlerës kontabël të pasurisë dhe shumës së vlerës së marrë dhe të arkëtueshme njihet në fitim ose humbje. Përveç kësaj çregjistrimin e një investimi në një instrument borxhi të klasifikuar si në VDPATGJ fitimi ose humbja kumulative e grumbulluar më parë në rezervën e rivlerësimit të investimeve është riklasifikuar në fitim ose humbje.

(i) Rritjet e konsiderueshme në rrezikun kreditorë

Në vlerësimin nëse rreziku i kredisë në një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare kompania krahason rrezikun e një mospagimi që ndodh në instrumentin financiar në datën e raportimit me rrezikun e një mospagimi të ndodhur në instrumentin financiar në datën e fillestare të njohjes. Për këtë vlerësim kompania konsideron si informacionin sasior ashtu edhe atë cilësor që është i arsyeshëm dhe i mbështetshëm përfshirë përvojën historike dhe informacionin e ardhshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Informacioni i ardhshëm i marrë në konsideratë përfshin perspektivën e ardhshme të industrive në të cilat veprojnë debitorët e kompanisë të marra nga raportet e ekspertëve ekonomikë analistët financiarë organet qeveritare dhe organizatat e tjera të ngjashme dhe shqyrtimin e burimeve të ndryshme të jashtme që parashikojnë informacione ekonomike që kanë të bëjnë me operacionet thelbësore të kompanisë. Në veçanti informacioni i mëposhtëm merret parasysh kur vlerësohet nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare:

- Një përkeqësim i dukshëm aktual ose i pritshëm i vlerësimit të jashtëm të instrumentit financiar (nëse është i disponueshëm) ose i brendshëm i kredisë;
- Përkeqësim i ndjeshëm i treguesve të tregut të jashtëm të rrezikut të kredisë për një instrument të veçantë financiar p.sh. një rritje e konsiderueshme në përhapjen e kredisë çmimet e këmbimit të parazgjedhur të kredisë për debitorinose kohëzgjatjen ose masën në të cilën vlera e drejtë e një aktivi financiar ka qenë më pak se kostoja e tij e amortizuar;

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

(i) Rritjet e konsiderueshme në rrezikun kreditorë (vazhdim)

- Ndryshime të pafavorshme ekzistuese ose parashikuese në kushtet e biznesitfinanciare ose ekonomike që pritet të shkaktojnë një rënie të konsiderueshme të aftësisë së debitorit për të përmbushur detyrimet e tij të borxhit
- Një përkeqësim i dukshëm aktual ose i pritshëm i rezultateve operative të debitorit
- Rritje e konsiderueshme të rrezikut të kredisë për instrumentet e tjerë financiarë të të njëjtit debitor
- Një ndryshim i dukshëm negativ aktual ose i pritshëm në mjedisin rregullatorekonomik ose teknologjik të debitorit që rezulton në një rënie të konsiderueshme të aftësisë së debitorit për të përmbushur detyrimet e tij të borxhit.

Pavarësisht nga rezultati i vlerësimit të mësipërkompania supozon se rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare kur pagesat kontraktuale kanë skaduar për më shumë se 30 ditëpërveç nëse kompania ka një informacion të arsyeshëm dhe të mbështetshëm që demonstroi ndryshe. Përkundër kësaj më sipërkompania supozon se rreziku i kredisë në një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse instrumenti financiar është përcaktuar të ketë rrezik të ulët kreditorë në datën e raportimit.

Një instrument financiar mund të ketë rrezik të ulët kreditor nëse:

- (1) Instrumenti financiar ka një rrezik të ulët të paracaktuar.
- (2) Nëse debitori ka aftësi të konsiderueshme për të përmbushur obligimet e tij kontraktuale në kohë.
- (3) Ndryshimet e pafavorshme në kushtet ekonomike dhe të biznesit në një afat të gjatë mund të zvogëlojnë aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale.

Kompania e konsideron një aktiv financiar të ketë rrezik të ulët kredie kur aktivi ka vlerësim të jashtëm të kredisë së 'shkallës së investimit' në përputhje me përkufizimin e kuptuar globalisht ose nëse një vlerësim i jashtëm nuk është i disponueshëmaktivi ka një vlerësim të brendshëm të 'performancës'. Vlerësimi i performancës do të thotë që pala kontraktuese ka një pozicion të fortë financiar dhe nuk ka obligime të skaduara.

(ii) Përkufizimi i paracaktuar

Kompania konsideron si në vijim një ngjarje të paracaktuar për qëllime të administrimit të rrezikut të brendshëm të kredisë pasi përvoja historike tregon që aktivet financiare që plotësojnë cilindo nga kriteret e mëposhtme në përgjithësi nuk janë të rikuperueshme apo informacioni i zhvilluar nga brenda ose i marrë nga burime të jashtme tregon se debitori nuk ka të ngjarë të paguajë kreditorët e tijpërfshirë edhe kompaninëplotësisht (pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur nga kompania). Pavarësisht nga analiza e mësipërmekompania konsideron që paracaktimi ndodhë kur një aktivi i kan kaluar më shumë se 90 ditë nga maturimpërveç nëse kompania ka një informacion të arsyeshëm për të demonstruar të kundërtën.

(iii) Pasuritë e dëmtuara nga kredia

Një aktiv financiar është i dëmtuar nga kredia kur një apo më shumë ngjarje kanë një impakt të dëmshëm në pritjet e ardhshme të rrjedhës së parasë. Evidentimi që një aktiv financiar është dëmtuar nga kredia përfshijnë të dhëna në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- (a) Vështirësia financiare e konsiderueshme e klientit.
- (b) Një shkelje e kontratës që mund të jetë një ngjarje e paracaktuar apo e ngjarje e mëparshme.
- (c) Huadhënësipër arsye të vështirësive ekonomike të huamarrësitka dhënë huadhënësit një koncesion që huadhënësi nukdo ta konsideronte ndryshe.
- (d) Nëse pritet që huadhënësi do të falimentojë; apo
- (e) Tregu aktiv për atë aktiv nuk egziston më për shkak të vështirësive financiare.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

Mosnjohja e pasurive financiare

Kompania regjistron një aktiv financiar vetëm kur skadojnë të drejtat kontraktuale të fluksit të parave nga aktivtose kur transferon aktivin financiar dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi në një entitet tjetër. Nëse kompania as nuk transferon dhe as nuk mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë aktivin e transferuar kompania njih interesin e saj të mbajtur në aktiv dhe një detyrim pasues për shumat që mund të duhet të paguajë. Nëse kompania mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar të transferuar atëherë kompania vazhdon të njohë aktivin financiar.

Detyrimet financiare

Të gjitha detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv ose në VDPFH. Sidoqoft detyrimet financiare që vijnë kur një transfer i një aktivi financiar nuk kualifikohet për njohje ose kur zbatohet qasja e vazhdueshme e përfshirjes kontratat e garancisë financiare të lëshuara nga kompaniamatën në përputhje me politikat specifike të kontabilitetit të përcaktuara më poshtë.

Detyrimet financiare klasifikohen në VDPFH kur detyrimi financiar është (i) konsiderim i kushtëzuar i një blerësi në një kombinim biznesi (ii) i mbajtur për tregtim ose (iii) i caktuar si në VDPFHmatën me metodën efektive të interesit.

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të shpërndarjes së shpenzimeve të interesit për periudhën përkatëse. Norma efektive e interesit është ajo normë që zbrit saktësisht pagesa të parave të gatshme (përfshirë të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranura që përbëjnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit koston e transaksionit dhe primeve tjera apo zbritjet) përgjatë afatit të pritshëm të detyrimit financiarose (kur është e përshtatshme) një periudhë më e shkurtër për koston e amortizuar të një detyrimi financiar.

d) Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare janë të paraqitura më koston e tyre duke ja zbritur ndonjë rënie në vlerë.

e) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartmonedhat dhe monedhat në qarkullimbancat e pakufizuara që mbahen në kompaniat qëndrore dhe pasuritë që janë shumë likuide me maturitet fillestar më pak se tre muajtë cilat i nënshtrohen rrezikut të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga kompania në menaxhimin e zotimeve afatshkurtëra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen sipas koston së amortizuar në pasqyrën e pozitës financiare.

f) Njohja e të ardhurave

Te ardhurat përfshijnë vlerën e drejte te shumes se marre ose qe eshte per t'u marre nga shitja e sherbimeve apo mallrave gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise. Te ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet dhe uljet. Te ardhurat njihen kur risqet dhe perfitimet kryesore lidhur me pronesine e mallrave jane transferuar tek bleresi, shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

g) Transkasionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta tjera që ndryshojnë nga valuta funksionale e kompanisë regjistrohen në kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datën e transaksionit. Në çdo periudhë raportuese zërat monetarë në valutë të huaj konvertohen në bazë të normave që mbizotërojnë në datën raportuese. Zërat jo-monetarë që maten në bazën e kostos historike në një valutë të huaj nuk konvertohen. Diferencat në këmbimin valutorë që paraqiten në zërat monetarë njihen si fitime ose humbje të periudhës në të cilën ato lindin.

h) Tatimi

Tatimi i tanishëm mbi të ardhurat kalkulohet në bazë të rregulloreve të aplikueshme në Kosovë ligjit nr. 06/L-105 mbi tatimin në fitim të korporatave i cili është publikuar më 27 qershor 2019.

i) Përfitimet e punonjësve

Kompania bën pagesa të kontributeve të obligueshme që ofrojnë përfitim të pensionit për punonjësit pasi të pensionohen.

j) Detyrimet e mundshme dhe provizionet

Detyrimet e mundshme nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse gjasat e ndodhjes së tyre dhe përfitimet ekonomike nuk janë larg. Një aset i mundshëm nuk njihet në pasqyra financiare por shpaloset nëse pritet ndonjë fluks i përfitimeve ekonomike. Një provizion njihet nëse si rezultat i ngjarjeve të mëparshme kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që benifitet ekonomike do të kërkojnë për të shlyer detyrimin.

Më 31 dhjetor 2022 kompania nuk ka pasur provizione dhe detyrime të mundshme.

4. Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar

(i) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Në vitin aktual, Kompania ka aplikuar një sërë ndryshimesh në SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë në fuqi për periudhën raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2023. Miratimi i tyre nuk ka pasur ndonjë material ndikim në dhënien e informacioneve shpjeguese ose në shumat e raportuara në këto pasqyra financiare.

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** botuar nga BSNK më 18 maj 2017. Standardi i ri kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matje dhe paraqitje për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë krijuar për të arritur qëllimin e një kontabiliteti konsistent dhe të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" dhe interpretimet përkatëse kur zbatohet. Ndryshimet në SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" të lëshuara nga BSNK më 25 qershor 2020 shtyjnë datën e zbatimit fillestar të SNRF 17 me dy vjet, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023. Për më tepër, ndryshimet e lëshuara më 25 qershor 2020 paraqesin thjeshtime dhe sqarime të disa kërkesave në Standard dhe ofrojnë lehtësira shtesë kur zbatohet SNRF 17 për herë të parë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Dhënia e informacioneve shpjeguese** të politikave kontabël të publikuara nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet kërkojnë që kompanitë të japin informacion shpjegues për politikat e tyre kontabël materiale në vend të politikave të tyre të rëndësishme kontabël dhe të ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të ndihmuar përgatitësit të vendosin se cilat politikat kontabël të shpalosen në pasqyrat e tyre financiare.
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet" - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël** të publikuar nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet fokusohen në vlerësimet kontabël dhe ofrojnë udhëzime se si të bëhet dallimi midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion** i vetëm i lëshuar nga BSNK më 6 maj 2021. Sipas ndryshimeve, përjashtimi nga njohja fillestare nuk zbatohet për transaksionet në të cilat, edhe differencat e përkoshme të zbritshme dhe të tatueshme, lindin në njohjen fillestare që rezultojnë në njohjen e barabartë të pasurive dhe detyrimeve tatimore të shtyra.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" - Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat Model Shtylla e Dytë** të lëshuara nga BSNK më 23 maj 2023. Ndryshimet prezantuan një përjashtim të përkohshëm nga kontabilizimi për tatimet e shtyra që rrjedhin nga juridiksionet që zbatojnë rregullat globale tatimore dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese rreth ekspozimit të kompanisë ndaj taksave mbi të ardhurat që rrjedhin nga reforma, veçanërisht përpara se legjislacioni që zbaton rregullat të jetë në fuqi.

Miratimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi nuk kanë guar në ndryshime materiale në pasqyrat financiare të kompanisë.

Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar (vazhdim)

(ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese akoma jo-efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese u nxorën nga BSNK mirëpo nuk janë akoma efektive:

- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" - Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe rimarrja me qira** të lëshuar nga BSNK më 22 shtator 2022. Ndryshimet në SNRF 16 kërkojnë që një shitës-qiramarrës të masë më pas detyrimet e qirasë që rrjedhin nga një rimarrje me qira në një mënyrë që ai të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Kërkesat e reja nuk e pengojnë një shitës-qiramarrës që të njohë në fitim ose humbje çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Klasifikimi i Detyrimeve afatshkurtëra ose afatgjata** të lëshuara nga BSNK më 23 janar 2020 dhe **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Detyrimet afatgjata të kushtëzuara** të lëshuara nga BSNK më 31 tetor 2022. Ndryshimet e lëshuara në janar 2020 ofrojnë një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në fuqi në datën e raportimit. Ndryshimet e nxjerra në tetor 2022 sqarojnë se si kushtet të cilat një kompani duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi dhe caktojnë datën efektive për të dy ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së Parasë" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese" - Marrëveshjet financiare të furnizuesve** të lëshuara nga BSNK më 25 maj 2023. Ndryshimet shtojnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese dhe "tabela sqaruese" brenda kërkesave ekzistuese për dhënie informacionesh shpjeguese cilësore dhe sasore në lidhje me marrëveshjet financiare të furnizuesit.
- **Ndryshimet në SNK 21 "Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor" - Mungesa e këmbyeshmërisë** të lëshuar nga BSNK më 15 gusht 2023. Ndryshimet përmbajnë udhëzime për të specifikuar kur një monedhë është e këmbyeshme dhe si të përcaktohet kursi i këmbimit kur nuk është në dispozicion.
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta" - Shitja ose kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët** të lëshuar nga BSNK më 11 shtator 2014. Ndryshimet trajtojnë një konflikt midis kërkesave të SNK 28 dhe SNRF 10 dhe sqarojnë se në një transaksion që përfshin një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, shkalla e njohjes së fitimit ose humbjes varet nëse pasuritë e shitura ose të kontribuuara përbëjnë një biznes.

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së hyrjes në fuqi. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

5. Prona, Pajisjet dhe Makineritë

<i>Kosto</i>	Toka	Kogjenerimi	Ndërtesa	Makina dhe Pajisje	Total
Më 01 janar 2022	356,405	13,449,545	2,612,795	1,403,194	17,821,939
Shtesat	-	2,322,435	-	401,411	2,723,846
Më 31 dhjetor 2022	356,405	15,771,980	2,612,795	1,804,605	20,545,785
Shtesat	-	-	-	90,946	90,946
Më 31 dhjetor 2023	356,405	15,771,980	2,612,795	1,895,551	20,636,731

Amortizimi i akumuluar

Më 01 janar 2022	-	(325,392)	(2,039,667)	(1,297,031)	(3,662,090)
Amortizimi për vitin	-	(741,562)	(138,321)	(10,672)	(890,555)
Më 31 dhjetor 2022	-	(1,066,954)	(2,177,988)	(1,307,703)	(4,552,645)
Amortizimi për vitin	-	(672,481)	(138,317)	(141,387)	(952,185)
Më 31 dhjetor 2023	-	(1,739,435)	(2,316,305)	(1,449,090)	(5,504,830)

Vlera kontabël neto

Më 31 dhjetor 2022	356,405	14,705,026	434,807	496,902	15,993,140
Më 31 dhjetor 2023	356,405	14,705,026	296,490	496,902	15,131,901

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Me 31 dhjetor 2023
 Të gjitha shumat në Euro

6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë:

	2023	2022
Më 31 dhjetor		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare bruto	1,031,461	966,808
Provizionimi i borxheve të këqija	(768,320)	(768,320)
Total	263,142	198,488

7. Stokset

Më 31 dhjetor

Lënda e parë

Mazuti

Biomasë

Stoku Donacion

Total

	2023	2022
	100,727	103,021
	54,097	54,097
	62,780	137,318
	31,854	-
Total	249,458	294,436

8. Pasuritë tjera afatshkurta

Më 31 dhjetor

Avanset parapagime

Avanset e dhëna

Parapagime

Nën-total

	2023	2022
	-	-
	4,676	7,882
Total	4,676	7,882

Tatimet:

Pagesat tepriçë ATK

TVSH e zbritshme

Total

	2023	2022
	9,934	9,934
	64,615	176,879
Total	79,225	194,695

9. Paraja dhe Ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 është paraqitur si më poshtë:

	2023	2022
Më 31 dhjetor		
Paraja në bank	161,261	174,210
Paraja në dorë	256	350
Total	161,517	174,560

10. Kapitali Aksionar

Me 31 dhjetor

Aksionari

Komuna e Gjakovës

Total në %

	2023	2022
Kapitali në %		
	100.00%	100.00%
Total	100.00%	100.00%

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

11. Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra paraqesin donacionet nga Komisioni Evropian, Komuna e Gjakovës etj. Ky regjistrim për raportim financiar është trajtuar sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmën Qeveritare

Me 31 dhjetor	2023	2022
<i>Afatgjata:</i>		
Te hyrat e shtyra - Koogjenerimi	11,779,199	12,451,676
Të hyrat e shtyra - KK Gjakove	464,208	489,328
Te hyrat e shtyra - Grante donacione tjera	482,435	523,581
Të hyrat e shtyra - SECO	2,137,083	2,253,350
Të hyrat e shtyra - Stoe	31,854	
Nën-Total (I)	14,894,779	15,717,935
<i>Afatshkurtra:</i>		
Te hyrat e shtyra - Koogjenerimi		-
Detyrimet nga të hyrat e shtyera-mazuti	63,835	63,835
Detyrimet nga te hyrat e shtyera - BIOMASE	74,080	162,035
Detyrimet nga të hyrat e shtyera		
Nën-Total (II)	137,915	225,870
Total (I+II)	15,032,694	15,943,805

12. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

Më 31 dhjetor	2023	2022
Llogaria e pagueshme tregtare	467,904	272,913
Total	467,904	272,913

13. Detyrimet tjera afatshkurta

Më 31 dhjetor	2023	2022
<i>Detyrime tjera</i>		
Obligimi ndaj sindikatës	147	-
Avanset e marrura	35,328	58,573
Nën-total	35,475	58,573
<i>Tatime dhe paga:</i>		
Obligim për paga	3	16
Kontributet pensionale	1,936	2,312
Tatimi në paga	943	931
Total	38,358	61,832

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumatat në Euro

14. Të hyrat

Të hyrat nga shitja më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

	2023	2022
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		
<i>Të hyrat nga operimet:</i>		
Të hyrat nga Ngrohja - Amviseritë	151,721	162,576
Të hyrat nga ngrohja - Afaristet	401,947	318,373
Të hyrat nga shitja e kyqjet e reja	3,073	5,901
Të hyrat nga zbritjet - (ditët e pangrohura)	(41,921)	(131,953)
Nën-total (I)	514,820	354,897
<i>Të hyrat tjera:</i>		
Te hyrat nga Donacionet - Amortizimi	855,010	793,380
Të hyrat nga subvencionet - Biomase	387,955	780,242
Të hyrat nga taksat gjyqësore	286	114
Të hyrat tjera	114,448	34,551
Nën-total (II)	1,357,700	1,608,287
Total (I+II)	1,872,519	1,963,184

15. Kosto e mallit të shitur

	2023	2022
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		
KMSH - Biomase	854,235	807,969
KMSH	135	547
Total	854,370	808,516

16. Shpenzimet e personelit

Përfitimet e punëtorëve për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

	2023	2022
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		
Pagat bruto	216,409	195,209
Kontributet punëdhënësi	10,745	9,530
Total	227,154	204,739

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Me 31 dhjetor 2023
Të gjitha shumat në Euro

17. Shpenzimet administrative

Shpenzimet tjera operative për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2023	2022
Shpenzimet e rrymes	32,843	31,373
Shpenzimet e ujit	5,122	14,551
Shpenzimet e taksave të ndryshme	4,995	4,304
Shpenzimet e borqeve të këqija	-	504
Shpenzimet tjera	4,686	4,043
Shpenzimet e Derivateve	2,261	3,744
Shpenzimet nga ndëshkimet - ATK	92	-
Shpenzimet e licensave	1,290	1,247
Shpenzimet e Auditimit	990	1,100
Shpenzimet e zyrës	1,882	262
Shpenzimet e telefonit	1,037	1,101
Shpenzimet Aparatet kunder-zjarrit	839	839
Shpenzimet për softwere të jashtme	761	761
Shpenzimet e provizioneve	718	616
Shpenzimet për mbeturina	1,326	1,326
Shpenzimet e shërbimeve të ndryshme	4,412	1,718
Taksa gjyqësore -r propozim përmbarim	303	127
Shpenzimet e reprezentacionit	329	1,486
Shpenzimet e automjeteve	515	234
Shpenzimet e pastrimit	44	949
Shpenzimet e interneti	407	538
Shpenzimet për gazra, acetilen, oksigjen	-	60
Domain -Hosting webfaqes	-	175
Shpenzimet e telefonit mobil	229	229
Shpenzimet e prodhimit	4,212	5,760
Shpenzimet e tjera - Stokset	-	2,797
Total	69,293	79,844

18. Shpenzimet e tatimit në fitim

Sipas ligjit nr. 03/L-162 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave", në fuqi nga 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ka qenë 10%.

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2023	2022
(Humbja) kontabël për vitin	(230,483)	(20,469)
Shpenzimet e papranuara	-	-
Fitimi i tatueshëm	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-

19. Transaksionet me palët e lidhura

Një person ose një palë e afërt e familjes së atij personi është e lidhur me Kompaninë raportuese nëse ai person:

- ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi Kompaninë raportuese;
- ka kontroll ose kontroll të përbashkët të Kompanisë raportuese;
- ka ndikim të rëndësishme mbi Kompaninë raportuese; ose
- është anëtar i menaxhmentit kyq të Kompaninë raportuese ose mëmë të Kompanisë raportuese.

Një entitet është i lidhur me Kompaninë raportuese nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtme aplikohet:

- Entiteti dhe Kompania raportuese janë anëtare të të njëjtit grup (që do të thotë që çdo entitet mëmë, filialë dhe degë filiale është e lidhur me të tjerët).
- Entiteti është shoqëri ose ndërmarrje e përbashkët e entitetit tjetër (ose një shoqëri apo ndërmarrje e përbashkët e një anëtar të grupit në të cilën shoqëria tjetër është anëtar).
- Të dyja entitetet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.
- Njëri entitet është ndërmarrje e përbashkët e e palës së tretë dhe entiteti tjetër është shoqëri e entitetit të tretë.
- Entiteti është një plan përfitimi pas punësimit për përfitimet e punëtorëve të entitetit raportues ose një entiteti të lidhur me entitetin raportues. Nëse entiteti raportues është një plan I tillë, punëtorët sponsorues janë gjithashtu të lidhur me entitetin raportues.
- Entiteti është i kontrolluar ose ka kontroll të përbashkët nga një person i afërt ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi.
- Një person i lidhur ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin ose është anëtar i menaxhmentit kyq të entitetit (ose Kompanisë mëmë të entitetit).

Një transaksion me një palë të lidhur është një transfer i resurseve, shërbimeve ose obligimeve mes Kompanisë raportuese dhe një pale të lidhur, pavarësisht nëse çmimi është ngarkuar.

Gjatë vitit Kompania kishte transaksione me palët e ndërlidhura si në vijim:

	2023	2022
Pagat për Bordin dhe Kryeshefin:		
Pagat për Bordin (Bruto)	12,307	13,200
Paga vjetore e Kryeshefit Ekzekutiv (Bruto)	13,197	11,728

20. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

a. Politikat e rëndësishme kontabël

Detajet e politikave kontabël dhe metodave të aplikuara, duke përfshirë kriterin e njohjes, bazën e matjes dhe bazën në të cilën njihen të hyrat dhe shpenzimet, në lidhje me secilën klasë të pasurisë financiare, detyrimit financiarë dhe instrumentit të kapitalit janë të shpalosura në shënimin 3 të pasqyrave financiare.

b. Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit 2023 dhe 2022 kompania kishte këto Instrumente financiare:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<u>Pasuritë financiare:</u>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	263,142	198,488
Stoqet	249,458	294,436
Pasuritë e tjera afatshkurtra	79,225	194,695
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	161,517	174,560
Totali	753,342	862,179
<u>Detyrimet financiare:</u>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	467,904	272,913
Detyrimet tjera afatshkurta	137,915	61,832
Totali	605,819	334,745

c. Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rreziqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në valutë të huaj dhe në normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të kompanisë përqendrohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga menaxhimi i kompanisë bazuar në disa politika dhe procedura të shkruara të paracaktuara me shkrim që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe fusha specifike, siç janë rreziku i këmbimit valutor, rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe menaxhimi i likuiditetit të tepërt.

d. Rreziku i tregut

Rreziku i valutës së huaj

Rreziku i valutave të huaja është rreziku që vlera e instrumenteve financiare ndryshon për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit të huaj kompania operon ndërkombëtarisht dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor që vjen nga ekspozimet e ndryshme të monedhës. Kompania nuk përdor asnjë instrument për të mbrojtur rrezikun e këmbimit valutor. Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës të ruajë pozicionin e duhur neto në secilën monedhë në total dhe operacionet e tij monitorohen çdo ditë nga menaxhmenti i kompanisë.

Kompania ndërmerr transaksione si në Euro ashtu edhe në valutë të huaj (rrallë herë). Mirëpo gjatë vitit 2023 dhe 2022 kompania nuk ka hyrë në transaksione të këtilla.

19. Vlera e drejtë dhe Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

d. Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturitetet e pasurive me interes ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes që përdoren për të financuar ato pasuri (rivlerësimi rrezikut). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit pasi që kompania nuk ka ndonjë detyrim të interesit në periudhën raportuese.

e. Rreziku kreditorë

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të kompanisë nëse klienti apo pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale. Kompania e ekspozimit të kredisë në lidhje me këtë, është paraqitur në vlerat kontabël të pasurive në pasqyrën e pozicionit financiarë. Llogaritë e arkëtueshme tregtare monitorohen në baza ditore dhe konsumatorët paralajmërohen menjëherë.

Vlera kontabël e pasurisë financiare në pasqyrat financiare, që nuk ndikohet nga humbjet, nëse ka, paraqet maksimumin e ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut kreditorë.

f. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që kompania do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënie të mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurta.

Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj në momentin kur ato skadojnë.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<u>Pasuritë financiare:</u>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	263,142	198,488
Stoqet	249,458	294,436
Pasuritë e tjera afatshkurta	79,225	194,695
Paraja dhe ekuivalentët e parase	161,517	174,560
Totali	753,342	862,179
<u>Detyrimet financiare:</u>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	467,904	272,913
Detyrimet tjera afatshkurta	137,915	61,832
Totali	605,819	334,745
Hapësira e Likuiditetit	147,523	527,434

g. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare janë të regjistruara mbi koston apo në koston e amortizuar në pasqyrat financiare përafrojnë vlerat e tyre të drejta për shkak të maturimit të tyre të shkurtër.

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

21. Kontigjencat dhe zotimet

Detyrimet ndaj tatimeve

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave për periudhën 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023 kështu që obligimet tatimore të Ndërmarrjes nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

Çështjet gjyqësore

Me 31 dhjetor 2023, Kompania nuk ka pasur ndonjë çështje gjyqësore të hapur.

22. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje tjera domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

